

29.07.2021
Ora 11:04

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tiranë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialpunetore Shqiptare, z. Florjan Hamit Rama ”.

PJESËMARRJA :

● **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Ilirjan Celibashi**

2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, B.Kodra**

● **Parti Politike:**

Z.I.Celibashi: Mirëdita të gjithëve! Atëherë fillojmë seancën publike sot për shqyrtimin e çështjeve në rend dite si vijon:

1. Projektvendim për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tiranë, me kandidatin nga lista shumemërore të Partisë Socialpunetore Shqiptare.
2. Projektvendim për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Kukës, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Ora e Shqipërisë.
3. Projektvendim për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tiranë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste.
4. Projektvendimi për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Korçë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste.
5. Projektvendimi për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Mirditë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialdemokrate.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.29.07.2021*

6. Projektvendimi në lidhje me procedurën e verifikimit për kandidatin e pavarur, zotin Boiken Abazi.

Atëherë vazhdojmë me radhë sipas renditjes.

Z.Y.Merkaj: Këshilli i Bashkisë Tiranë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në këtë këshill, nga zonja Ueda Bashkim Kaçi, propozuar nga Partia Socialpuunëtore e Shqipërisë. Bazuar në nenin 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialpuunëtore Shqiptare për Këshillin e Bashkisë Tiranë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 3, zoti Florjan Hamit Rama. Kandidati për anëtar të Këshillit Bashkiak ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit me numër unik: 2169. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit rezulton se nuk ka të deklaruar asnjë të dhënë, e cila ka të bëjë me parashikimet për ndalim, në ligjin nr.138, të vitit 2015, për dekriminalizimin. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe Zyra e Gjendjes Gjyqësore, ku në përgjigje të kërkesës sonë, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka kthyer përgjigje që nuk ka ndryshime në përbërjen gjyqësore të kandidatit për anëtar të Këshillit të Bashkisë Tiranë, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve verifikimin e gjendjes gjyqësore, ku rezulton se është i padënuar dhe nuk ka shënime në sistem. Referuar pikës 2, të kreut të pestë, të vendimit nr.17, të vitit 2016 të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar të Këshillit të Bashkisë Tiranë, zotit Florian Hamit Rama nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.29.07.2021*

Z.I.Celibashi: Faleminderit! Atëherë, bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “n” dhe pika 2, dhe nenit 164, pika 2 dhe 4, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë si dhe ligji nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe Vendimit nr.17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë vendos:

1. Zoti Florjan Hamit Rama kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Tiranë nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tiranë të kandidatit nga lista shumemërore të Partisë Socialpunëtore Shqiptare, zotit Florjan Hamit Rama.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

Vendimi nr.433

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



29.07.2021
Ora 11:08

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Kukës, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Ora e Shqipërisë, znj. Onerda Xhevdet Sopaj ”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**


2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, B.Kodra**

• **Parti Politike:**

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës!

Z.Y.Merkaj: Këshilli i Bashkisë Kukës ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltarja zonja Ketiona Xhevdet Sopaj, propozuar nga Partia Ora e Shqipërisë. Referuar nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Ora e Shqipërisë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit është kandidati me numër rendor 4, zonja Onerda Xhevdet Sopaj, e cila ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit me numër unik: 2168. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit rezulton se nuk ka deklaruar të dhëna, të cilat kanë të bëjnë me ndalimet në ligjin nr.138, të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe Zyra e Gjendjes Gjqësore, ku në përgjigje të kërkesës sonë, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ka kthyer

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.29.07.2021*

përgjigje, rezulton që nuk ka ndryshime në përbërjen e gjendjes civile ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore, ku rezulton se nuk ka shënime në sistem, pra është e padënuar. Referuar pikës 2, të kreut të pestë, të vendimit nr.17, të vitit 2016 të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar të Këshillit të Bashkisë Kukës, të zonjës Onerda Xhevdet Sopaj nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!


Z.I.Celibashi: Faleminderit! Atëherë, bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “n” dhe pika 2, si dhe neni 164, pika 2 dhe 4, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, si dhe ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike, si dhe vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr.17/2016, vendos:

1. Zonja Onerda Xhevdet Sopaj, kandidat për anëtar të Këshillit të Bashkisë Kukës nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Kukës me kandidatin nga lista shumëëmërore të Partisë Ora e Shqipërisë zonja Onerda Xhevdet Sopaj.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

Vendimi nr. 434

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



**29.07.2021
Ora 11:11**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tiranë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste e Shqipërisë, z. Eni Sadik Bistri ”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Ilirjan Celibashi**
2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, B.Kodra**
- **Parti Politike:**

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës!

Z.Y.Merkaj: Këshilli i Bashkisë Tiranë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, Artur Refik Sula, propozuar nga Partia Socialiste. Referuar në nenin 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste për Këshillin e Bashkisë Tiranë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 62, zoti Eni Sadik Bistri, i cili ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit me numër unik: 2172. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit konstatohet se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë, të cilat kanë të bëjnë me parashikimet për ndalim të ligjit nr.138, të vitit 2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe Zyra e Gjendjes Gjyqësore, ku në përgjigje të kërkesës sonë, Drejtoria e Përgjithshme e

***Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU***



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.29.07.2021*

Gjendjes Civile nuk ka kthyer ende përgjigje, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar verifikimin e gjendjes gjyqësore, ku rezulton se është i padënuar dhe nuk ka shënime në sistem. Referuar pikës 2, të kreut të pestë, të vendimit nr.17, të vitit 2016 të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar të Këshillit të Bashkisë Tiranë, zotit Eni Sadik Bistri nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e tij, në funksionin e këshilltarit.

Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim!

Z.I.Celibashi: Atëherë, bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “n” dhe pika 2, si dhe neni 164, pika 2 dhe 4, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, si dhe ligji nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen apo emërohen ose ushtrojnë funksione publike, si dhe vendimit nr.17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, vendos:

1. Zoti Eni Sadik Bistri kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Tiranë nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Tiranë me kandidatin nga lista shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë zoti Eni Sadik Bistri.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Vendimi nr. 435

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Korçë, me kandidatin nga lista shumëmërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, znj. Ornela Petrit Alikaj”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**

2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, B.Kodra**

• **Parti Politike:**

Z.I.Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës!

Z.Y.Merkaj: Këshilli i Bashkisë Korçë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zonja Enslemvera Vehbi Zake propozuar nga Partia Socialiste. Referuar nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor, kandidati vijues nga lista shumëmërore e Partisë Socialiste që i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 36, zonja Ornela Petrit Alikaj, e cila ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit me numër unik: 2171. Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit konstatohet se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë, e cila ka të bëjë me parashikimet për ndalimin e ligjit nr.138, të vitit 2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe Zyra e Gjendjes Gjyqësore, ku

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.29.07.2021*

në përgjigje të kërkesës sonë, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ende nuk ka kthyer përgjigje, ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve verifikimin e gjendjes gjyqësore, ku rezulton se është i padënuar dhe nuk ka shënime në sistem. Referuar pikës 2, të kreut të pestë, të vendimit nr.17, të vitit 2016 të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar të Këshillit të Bashkisë Korçë, zonjës Ornela Petrit Alikaj nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

Z.I.Celibashi: Atëherë, dhe për zonjën Ornela Petrit Alikaj, kandidate për anëtar në Këshillin e Bashkisë Korçë,

1. Rezultoni se nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Korçë me kandidatin nga lista shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, zonjën Ornela Petrit Alikaj.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankimi në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

Vendimi nr. 436

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

